



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 29, datë 12.06.2026



PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË 2,845,208 LEKË, PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR DËME SI PASOJË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESAT E TYRE

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Financave me nr. 492/1 prot, datë 25.02.2025 me kodin e produktit: "*Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme*"- kodi i produktit 91707AB" dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:**

1. Miratimin e ndihmës financiare me vlerë 2,845,208 (dymilion e tetëqind e dyzet e pesë mijë e dyqind e tetë) lekë, për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre, sipas tabelës së mëposhtëme:

Nr	Emër Mbiemër	Njësia Administrative	Data e kërkesës	Preventivi per orendit/sendet llogaritur nga KQD	Preventivi per materiale ndertimi llogaritur nga KQD, ne masen 50 % sipas VKM-së 329, datë 16.5.2012,	Vlera e dëmit totale përfutues
1	Altin Kuqi	Nr.3	12.12.25	863,101	196,261	1,059,362
2	Gazmore Mane	Rrashbull	06.10.25	246,379	163,575	409,954
3	Zeq Hoxhaj	Nr.6	14.10.25	349,249	89,355	438,604
4	Besnik Seferi	Nr.6	23.02.26	305,252	36,292	341,544
5	Gëzim Jaupi	Nr.6	20.05.25	300,548	295,196	595,744
Total						2,845,208

- Ky financim do të merret nga fondi i kushtëzuar për emergjencat civile, për vitin 2026 i alokuar me shkresën nr.429/6 prot, datë 15.04.26 të Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me kodin e produktit: “Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”- kodi i produktit 91707AB.
- Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR

Denisa Lharasi



U shpall sot me datë 15.06.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 417prot.
8

Durrës, më 18.06.2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS
KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 29 datë 12.06.2026 “Për miratimin e ndihmës financiare me vlerë 2,845,208 lekë, për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre.”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

**PREFEKTI
ADRIAN GURRA**

